



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2020

Lënda: Përgjigje kërkesë për informacion

Rruga _____, Shkodër

e.mail: _____

Në vijim të kërkesës suaj nr.135, datë 14.04.2020, drejtuar Bashkisë Shkodër me anë të portalit “pyetshtetin.al”, dhe regjistruar me nr.5841 prot., datë 24.04.2020, në të cilën bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të Drejten e Informimit” kërkonti informacion mbi fondin rezervë dhe të kontigjencës të parashikuar nga Bashkia Shkodër, fondin e emergjencës të miratuar si dhe sa ka qenë vlera e buxhetit të shpenzuar deri në këtë moment për të përballuar gjendjen e krijuar nga COVID-19, ju bëjmë me dije se:

Informacionin që ju kërkonti, mund ta gjeni në faqen e Bashkisë Shkodër duke klikuar në:

http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/PBA_2020_2022_1473_1.php

http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Vendimet_e_Keshillit_169_1.php

Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 26 Dt.: 30.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 afatmesëm përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë së Shkodrës”

Në mbështetje të nenit 65, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

“Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej **4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit**”.

Sipas shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr 23198/1, datë 24.12.2019, Bashkia ka parashikuar 1.7% të fondeve të veta në shumën 24,915 mijë lekë për mbrojtjen civile, me VKB nr. 26 datë 30.12.2019 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2020 dhe të programit buxhetor afatmesëm përfundimtar të Bashkisë Shkodër për vitin 2020-2022“. në Programin 03280 "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile" , zëri "Transferime", në kërkesën buxhetore P03280.O1.A1."Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i

strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër", aktiviteti "Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile".

Fondi 4% prej 58,622,000 Lekë, sigurohet nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit, të cilat nuk janë alokuar akoma.

Bashkia Shkodër po vazhdon punën për përballimin e situatës me fondet e veta.

Në http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/ndryshim_buxheti_2984.pdf gjeni Pr/vendim: “Për një ndryshim në VKB nr.26, datë 30.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë Shkodër“. Ky projekt vendim është miratuar nga Këshilli i Bashkisë

Në http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Njoftime_Shpallje_223_1.php, gjeni informacion të përditësuar të masave të ndërmarra nga Bashkia Shkodër për përballimin e situatës të shkaktuar nga COVID-19

Duke ju uruar, mbarëvajtje në punë.

KRYETAR

Voltana ADEMI

Konceptoi: D. Cico